



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALFRED J. VASIL
ADRESA NR.10, BLV"GJERGJ
FISHTA", NR.88, NR.1, NR.1
TEL: 672018025



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 225

Nr. koleksioni: 91

Tirane më 30/06/2021

11

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021051320010135185



KONTRATË SHITBLERJE **KUOTASH KAPITALI**

Sot më datë 30, të muajit Qershor, të vitit 2021 (dymijë e njëzet e një), para meje noterit publik, Alfred J. VASIL, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati E-88; kati i dytë, zyra nr. 1, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të poshtëshënuara, të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "ERGI" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I. PALET

Pala Shitëse: **Gentian Daja**, shtetas shqiptar, i biri i Tahir dhe Mukades, i datëlindjes 19.07.1976, lindur në Kavajë dhe banues në adresën rruga "Besa", Qerret, Kavajë (sipas deklaramit të tij), madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034491658 dhe numër personal H60719076T, i cili paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "ERGI" SHPK.

Dhënëse Pëlqimi: **Silvana Daja**, shtetase shqiptare, e bija e Seid dhe Lutfije, e datëlindjes 30.01.1985, lindur në Kavajë dhe banuese në adresën rruga "Besa", Qerret, Kavajë (sipas deklaramit të saj), madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 034491620 dhe numër personal I55130082S, e cila paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e bashkëshortes së z. Gentian Daja dhe për rrjedhojë bashkëpronare, për efekt martese, në kuotën që z. Daja zotëron në shoqërinë "ERGI" SHPK.

Pala Blerëse: **Skënder Pashaj**, shtetas shqiptar, i biri i Imer dhe Razije, i datëlindjes 23.02.1970, lindur në Durrës dhe banues në adresën rruga "Aleksandër Goga", Durrës (sipas deklaramit të tij), madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. 031588529 dhe numër personal H00223181O.

Kushtet Paraprake

- Shoqëria "ERGI" SHPK, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) K72522812K me zyrë qendrore në Tiranë, rruga "Besa", Zona Kadastrale 3101, pasuria nr. 14/35, Qerret, Golem, Tiranë; me kapital të regjistruar 300,000 (treqind mijë) lekë; me ortak të vetëm z. Gentian Daja, zotëruar i 1 (një) kuote, e cila përbën 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë; me administrator z. Astrit Daja;
- Pala shitëse është e interesuar të shesë pjesën e kuotës e cila përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ERGI" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë pjesë të kuotës;
- Palët paraprakisht kanë rënë dakord që çmimi i kësaj kontrate do të paguhet nga pala blerëse me këste;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Gentian Daja, i shet palës blerëse Skënder Pashaj, pjesën e kuotës që zotëron në shoqërinë "ERGI" SHPK dhe e cila përbën 50% të kapitalit të regjistruar të kësaj shoqërie. Për efekt të kësaj shitje kuota e zotëruar nga z. Daja pjesëtohet dhe pas shitjes shoqëria do të ketë 2 kuota, njëra e zotëruar nga z. Gentian Daja, e cila do të përbëjë 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ERGI" SHPK dhe njëra e zotëruar nga z. Skënder Pashaj e cila do të përbëjë 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ERGI" SHPK.



A2021051320010135185

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në QKB, ortakët e shoqërisë "ERGI" SHPK, do të jenë:

- Z. Gentian Daja, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ERGI" SHPK;
- Z. Skënder Pashaj, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ERGI" SHPK.

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së pjesës së kuotës objekt i kësaj kontrate, është 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse direkt në llogarinë bankare të komunikuar nga pala shitëse Gentian Daja.

3.2 Për çdo vonesë në pagesën e çmimit, do të aplikohet një interes në masën 10% në vit.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj ka/në të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar dhe teknik të shoqërisë "ERGI" SHPK.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 e 3.2 të kësaj kontrate.

4.3 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, palët bien dakord të marrin vendime lidhur me ndryshimin e administratorit të shoqërisë si dhe fillimin e procedurave për ndarjen e shoqërisë "ERGI" SHPK, në dy shoqëri të reja, ku njëra do të mbajë vetëm aktivitetin e hotelieri – turizëm dhe tjetra aktivitetet e tjera që ka shoqëria "ERGI" SHPK. Modalitetet për ndarjen e shoqërisë, do të përcaktohen në një akt marrëveshje të veçantë midis palëve të kësaj kontrate Gentian Daja dhe Skënder Pashaj.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe z. Skënder Pashaj do të bëhet ortak në shoqërinë "ERGI" SHPK, duke zotëruar 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e pjesën e kuotës e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërinë "ERGI" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse Skënder Pashaj.

VI. DHËNËSJA E PËLQIMIT

Dhënësja e pëlqimit znj. Silvana Daja, bashkëshorte e ortakut Gentian Daja dhe bashkëpronare, për efekt martese, në kuotën që Gentian Daja zotëron në shoqërinë "ERGI" SHPK, deklaron se është dakord që pjesa e kuotës, objekt i kësaj kontrate, ti shitet z. Skënder Pashaj dhe pas kësaj shitje palët të procedojnë lidhur me të gjitha ndryshimet e tjera të rëna dakord në këtë kontratë dhe specifikisht edhe me ato të parashikuara në nenin 4.3 të kësaj kontrate.

Dhënësja e pëlqimit znj. Silvana Daja, deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë shitje të pjesës së kuotës dhe nuk do të ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me shitje apo me çdo vendimarrje tjetër që z. Gentian Daja po ndërmerr e do ndërmarrë, në marrëdhënien tregtare me z. Skënder Pashaj, në shoqërinë "ERGI" SHPK; si dhe nuk ka e nuk do të ketë asnjë pretendim në të ardhme lidhur me të gjitha vendimarrjet lidhur me të gjitha ndryshimet e tjera të rëna dakord në këtë kontratë dhe specifikisht edhe me ato të parashikuara në nenin 4.3 të kësaj kontrate.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.



A2021051320010135185

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

PALA SHITËSE

GENTIAN DAJA

Gentian Daja

DHËNËSE E PËLQIMIT

SILVANA DAJA

Silvana Daja

[Signature]

PALA BLERËSE

SKËNDER PASHAJ

Skender Pashaj

[Signature]

NOTER

Alfred J. VASIL

Alfred J. Vasil

